



Planuar / Doretuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivory	06-07-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SDMSICK	3954/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.507/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.507/2022 të datës 07.06.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.507/2022 e datës 07.06.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.18/2022 i datës 20.05.2022, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 13.04.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm, për pozitën e punës "Zyrtar për distribuimin e dokumenteve 1" ,në Prokurorinë Themelore në Pejë. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 13.04.2022 deri me datën 27.04.2022, ku si pjesëmarrës në këtë konkurs ka qenë edhe ankuesi: [redacted]. Në listën e ngushtë të datës 06.05.2022, e publikuar nga ana e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, janë përfshirë vetëm tre (3) kandidatë, ndërsa ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë lidhur me këtë pozitë. Kurse bazuar në Njoftimin për përzgjedhje përfundimtare të datës 24.05.2022 të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si kandidat i suksesshëm lidhur me këtë pozitë është shpallur G.Gj me gjithsejtë 60.6 pikë në total.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e komisionit rekrutues të kandidatëve, lidhur me mos pranueshmërinë e përvojës së punës, me datën 12.05.2022 parashtron ankesë në Komisionin për



Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.18/2022 të datës 20.05.2022, refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 11.05.2022 përmes e-mailit zyrtar, duke lënë në fuqi njoftimin e datës 06.05.2022 i lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KA.Nr.18/2022 të datës 20.05.2022, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, me datën 07.06.2022 brenda afatit ligjor, parashtron ankesën me numër të protokollit 3311/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se i njëjti nuk është përfshirë në listën e ngushtë nga ana e Komisionit të Rekrutimit të SKPK-së edhe përkundër se i ka dorëzuar dëshmitë lidhur me përvojën e punës për pozitën në të cilën ka aplikuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 09.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar SKGJK), ndërsa me datën 21.06.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3607/22 së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 07.06.2022 me numër protokollit 3311/2022, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 13.04.2022; Dëshmitë mbi përvojën e punës së ankuesit së bashku me trust; Vendimin KA.Nr.18/2022 të datës 20.05.2022 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin A.nr.570/2018 të datës 22.10.2018 nga KPMSHCK; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.06.2022 nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin Nr.Prot.DPSKPK/170/2022 të datës 29.04.2022 lidhur me formimin e komisionit rekrutues; Njoftimin e datës 06.05.2022 lidhur me njoftimin e kandidatëve për listën e ngushtë; Regjistrin me aplikacionet e pranuar të kandidatëve; Raportin e datës 05.05.2022 lidhur me listën e ngushtë; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së listës së ngushtë të datës 05.05.2022; Përmbledhjet e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë të datës 05.05.2022; Përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Deklaratat për mos ekzistimin e konfliktit të interesave të datës 05.05.2022 të anëtarëve të komisionit rekrutues; Njoftimin e datës 24.05.2022 lidhur me përzgjedhjen përfundimtare; Rekomandimin për emërimin e kandidatit të datës 23.05.2022; Raportin final të rekomandimit nga komisioni rekrutues të datës 18.05.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 18.05.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës të datës ; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së testit me shkrim të datës 16.05.2022; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim të datës 16.05.2022; Përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj të datës 13.05.2022; Formularët e vlerësimit individual përfundimtar të kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj të datës 18.05.2022 për kandidatët konkurrues; Formularin përmbledhës të vlerësimeve individuale të intervistës të datës 18.05.2022; Formularët e vlerësimit individual të intervistës me gojë për kandidatët konkurrues të datës 18.05.2022; E-mailin zyrtar të datës 29.04.2022; E-mailin zyrtar të datës 11.05.2022; E-mailin zyrtar të datës 17.05.2022; Njoftimet lidhur me mbajtjen e testit me shkrim



dhe intervist për kandidatët konkurrues; Procesverbalin e datës 13.05.2022 te Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin zyrtar te datës 12.05.2022; Ankesën e ankuesit të datës 12.05.2022 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Deklaratën për mosekzistim te konfliktit te interesit te datës 13.04.2022 nga kandidati A.P; Testet me shkrim të datës 13.05.2022 nga kandidatet aplikues; Deklaratën për mosekzistim te konfliktit te interesit te datës 13.04.2022 nga kandidati G.Gj; Deklaratën për mosekzistim te konfliktit te interesit te datës 13.04.2022 nga kandidati

Aplikacionin me nr.178 te datës 22.04.2022 nga kandidatja A.K se bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë te punës; Aplikacionin me nr.108 te datës 15.04.2022 nga kandidati G.Gj se bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë te punës; Aplikacionin me nr.130 te datës 20.04.2022 nga kandidati A.P se bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë te punës; Aplikacionin me nr.353 te datës 28.04.2022 nga kandidati G. S se bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë te punës; Aplikacionin me nr.136 te datës 20.04.2022 nga kandidati L. L se bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë te punës; Aplikacionin me nr.109 te datës 15.04.2022 nga kandidati B.S se bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë te punës; E-mailat zyrtar të datës 04.07.2022; E-mailat zyrtar te datës 10.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën "Zyrtar për distribuimin e dokumenteve 1, në Prokurorinë Themelore në Pejë, ka përcaktuar si kritere themelore: **Përgatitja profesionale dhe kualifikimi -Shkolla e mesme, Përvoja e punës- Së paku 3 vite përvojë pune.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga organi i punësimit dhe ankuesi, ka konstatuar se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën "Zyrtar për distribuimin e dokumenteve 1" në Prokurorinë Themelore në Pejë, si dëshmi mbi përvojën profesionale ka paraqitur diplomën me numër 962 të datës 18.06.2020 sipas se cilës ka përfunduar me datë 08.02.2020 studimet themelore dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë pranë Universitetit "Haxhi Zeka" ne Pejë, ndërsa lidhur me përvojën e punës ka bashkangjitur Certifikatën me numër SKPK/DBNJ/Nr.11 të datës 22.03.2022 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kryerjen e stazhit të praktikës në bazë vullnetare pa pagesë për periudhën prej një (1) viti nga data 22.03.2021 deri me datën 21.03.2022 në Prokurorinë Themelore në Pejë si dhe Kontratën e punës për kohë të caktuar/pa caktuar e lidhur në Prishtinë me datën 03.06.2021, ndërmjet ankuesit në pozitën "Roje" dhe Kompanisë së Sigurimit Fizik "Alpha Private Security" SH.P.K, mirëpo që e njëjta mban vetëm vulën e kompanisë dhe nënshkrimin e ankuesit e jo edhe nënshkrimin e punëmarrësit, poashtu ka dorëzuar edhe pasqyrën e trustit për periudhën prej 01.08.2002-08.04.2022. Ndërlidhur me këtë, Kolegji ka analizuar dëshminë e datës 12.05.2022, kur ankuesi përmes e-mailit zyrtar dërgon tek Zyra e Burimeve Njerëzore pranë Sekretariatit te Këshillit Prokurorial te Kosovës, dëshmi mbi përvojën e punës në të cilën ka bashkangjitur kontratën e punës tek Kompania e Sigurimit Fizik "Alpha Private Security" SH.P.K në pozitën "Roje" dhe dëshminë mbi trustin ,prandaj ka konstatuar se konkursi për pozitën e lartcekur ka qenë i hapur prej datës 13.04.2022 gjer me datën 27.04.2022, ndërsa ankuesi pas mbylljes se konkursit ka dorëzuar dëshminë mbi përvojën e punës pra konkretisht me datën 12.05.2022, rrjedhimisht bazuar në këto dëshmi rrjedhë së ankuesi ka plotësuar kriterin e arsimit por jo edhe përvojës së punës, pasi që i njëjti nuk ka arrit të vërtetoj se ka mbi tri (3) vite përvojë pune





profesionale siç është përcaktuar me konkurs, kështu që pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e mos përfshirjes në listën e ngushtë të ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 21 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilin përcaktohet që: "Se bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatet duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues në vijim: 2.1.kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të bashkangjitura në aplikacion; kopjet e dëshmisë së punësimit (për kandidatët të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil) ose kopjet e të dhënave nga te punësimit nga Regjistri i Shërbimit Civil ose një regjistër ekuivalent , i cili përdoret në Shërbimin Civil të Kosovës", e po ashtu edhe në pajtim me nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilin përcaktohet që: "1.Aplikacionet dorëzohen në afatin e përcaktuar në adresën përmes postës së regjistruar ose përmes mjeteve elektronike të komunikimit, e përcaktuar në shpalljen për rekrutim.2.Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.18/2022 të datës 20.05.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.507/2022, datë 06.07.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës,
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe ;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

